ÇËSHTJE TË LEKSIKUT DITUROR NË VEPRAT E NAIM FRASHËRIT

Abdurrahim MAXHUNI

Instituti Albanologjik, Prishtinë

Përmbledhje

Krijimi dhe përdorimi i termave janë dukuri të hershme në zhvillimin e gjuhëve, ndërsa terminologjia si disiplinë shkencore është formësuar shumë më vonë. Në hapësirën shqiptare, përpjekjet individuale për krijimin dhe përdorimin e termave i paraprinë punës së organizuar terminologjike. Ndonëse elemente terminologjike ndeshen që në librat e parë të shqipes, rëndësi të veçantë kjo fushë mori gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në kuadër të përpjekjeve për zhvillimin e shqipes si gjuhë e arsimit, e kulturës dhe e dijes. Hartimi i teksteve shkollore, si dhe nevoja për përdorimin e shqipes në veprimtarinë administrative e shtetërore, nxitën krijimin dhe pasurimin e leksikut me emërtime për koncepte të fushave të ndryshme. Një nga personalitetet që dhanë ndihmesë të rëndësishme në pasurimin e leksikut dituror të shqipes ishte Naim Frashëri. Veprimtaria e tij letrare dhe didaktike dëshmon përpjekjet për zgjerimin e mundësive shprehëse të shqipes dhe për përdorimin e saj në shpjegimin e njohurive nga fusha të ndryshme. Në këtë kumtesë shqyrtohen disa veçori të leksikut dituror në veprën e Naim Frashërit, duke u përqendruar te mënyrat e krijimit dhe të përdorimit të emërtimeve, si dhe te kontributi i tij në pasurimin e leksikut shqip. Baza e analizës është vepra e Dhimitër Shuteriqit *Fjalor i Naim Frashërit*.

Fjalët çelës: leksik dituror, leksik terminologjik, Rilindje Kombëtare, Naim Frashëri.

Abstract

The creation and use of terms are longstanding phenomena in the development of languages, whereas terminology as a scientific discipline took shape much later. In the Albanian-speaking context, individual efforts to create and use terms preceded organized terminological work. Although terminological elements can be found in the earliest Albanian books, this field gained particular importance during the Albanian National Renaissance, as part of broader efforts to develop Albanian as a language of education, culture, and knowledge. The preparation of school textbooks, together with the need to use Albanian in administrative and state affairs, encouraged the creation and enrichment of the lexicon with designations for concepts from various fields. One of the figures who made a significant contribution to enriching the knowledge-related lexicon of Albanian was Naim Frashëri. His literary and didactic work reflects efforts to expand the expressive resources of Albanian and to use the language to explain knowledge from various fields. This paper examines several features of the knowledge-related lexicon in Naim Frashëri's works, focusing on the ways in which designations were formed and used, as well as on his contribution to enriching the Albanian lexicon. The analysis is based on Dhimitër Shuteriqi's work *Fjalor i Naim Frashërit* (*Dictionary of Naim Frashëri*).

Keywords: knowledge-related lexicon, terminological lexicon, Albanian National Renaissance, Naim Frashëri.

Hyrje

Historia e terminologjisë shqipe është e lidhur ngushtë me historinë e gjuhës shqipe, me zhvillimin e saj, me historinë saj si gjuhë e shkruar. Andaj zhvillimi i terminologjisë mund të hetohet me hapat e zhvillimit të gjuhës së shkruar shqipe. Kjo fazë fillon me tekstet e para shqipe, me autorët e vjetër, të cilët në tekstet e tyre hasen një leksik special, sigurisht jo si një sistem i organizuar, por si fjalë të leksikut të zakonshëm që kishin potencial të shënonin koncepte të caktuara nga fusha e terminologjisë, të cilët fillimisht kanë funksionuar si njësi speciale, për të kaluar më vonë në terma. Kur themi leksik special i përdorur nga autorë të vjetër, nënkuptohet leksiku i asaj kohe që ka pasur potencial për të marrë statusin e termave, sepse leksiku që ka shënuar koncepte të caktuara ka qenë në nivelin e fjalëve të zakonshme. Potenciali i këtij leksiku është parë vetëm në kohën e fillimit të formimit të sistemeve terminologjike, tek në fillim të shekullit XX, i ndikuar kryesisht nga faktorë jashtëgjuhësorë,

me rastin e pavarësimit të Shqipërisë, kur u krijua nevoja për leksik të specializuar për të shënuar konceptet e fushës politike e administrative e nga faktorë brenda gjuhësorë, me rastin e hartimit të abetareve, të teksteve shkollore, të gramatikave, të fjalorëve e të përkthimeve etj. Në historinë e shkrimit shqip, për herë të parë paraqitjen e disa termave e hasim tek autorët e vjetër, si te Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdan etj.[1] Edhe pse shkrimet e tyre ishin më tepër me karakter fetar, mund të haset ndonjë term, që me kalimin e kohës ose është zhdukur ose ka vazhduar të jetojë, por shpesh duke e ndërruar kuptimin. Pra, përveç terminologjisë kishtare që deri diku kishte një nivel të përpunimit, duke u plotësuar edhe me terma të huaj, terminologjia e fushave të tjera ishte mjaft e varfër dhe termat e përdorur në atë kohë ishin të kufizuar në sasi dhe nuk i plotësonin të gjitha nevojat e komunikimit, për shkak të numrit të vogël të veprave dhe përhapjes së tyre të kufizuar.[2] Duke u bazuar në këtë mund të themi se periudha e Rilindjes Kombëtare konsiderohet koha kur puna me terminologjinë ishte e vetëdijshme.

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare ekzistoi një vetëdije më e madhe individuale e rilindësve për terminologji. Ata përveç krijimit të neologjizmave, gjatë botimit të teksteve mësimore të lëndëve të shumta, botuan tekste dhe vepra të tjera me karakter letrar, gjuhësor, historik, fetar etj., duke krijuar terma nga brumi i shqipes, por edhe duke shqipëruar terma të huaj. Ndër këta autorë mund të përmendim K. Kristoforidhi, S. Frashëri, N. Frashëri, J. Vreto etj., të cilët shfrytëzuan mjaft mirë mundësitë që ofronte struktura e gjuhës shqipe për të arritur qëllimet e tyre në këtë drejtim. E gjithë kjo erdhi si nevojë pas hapjes së shkollave shqipe.

Nismat individuale, ndonjëherë edhe kolektive rreth mbledhjes, përpunimit dhe zhvillimit të termave, ndonëse shumë të kufizuar, flasin për vetëdijesimin e intelektualëve në lidhje me rëndësinë që kishte terminologjia. Një punë e organizuar kolektive, ndonëse me përmasa të ngushta, u jetësua me formimin e Komisisë Letrare të Shkodrës 1916-1918, nga e cila në janar 1918 u botua një listë termash të gjyqësisë dhe të administratës në gjuhën shqipe me gjegjëset turqisht, latinisht e gjermanisht.

Krijimi i Sektorit të Terminologjisë më 1955 në Tiranë, në Institutin e Gjuhësisë dhe Historisë ndihmoi në masë të madhe në zhvillimin e terminologjisë leksikografike, përkatësisht në botimin e fjalorëve terminologjikë e shpjegues. Leksikografia shqiptare filloi me Fjalorin latinisht-shqip të F. Bardhit më 1635 për të vazhduar më tej me fjalorin e Kristoforidhit, më 1904. Vepra e parë e madhe në fushën e fjalorëve shpjegues kombëtarë është "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954), i hartuar nga Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni, Osman Myderrizi, botim i Institutit të Shkencave Shoqërore. Ky është i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë i shqipes. Ai hapi etapën e fjalorëve shpjegues kombëtarë e normativë dhe është hartuar sipas parimeve e kritereve shkencore, që shtrohen për çdo fjalor shpjegues kombëtar. Studimi i Kostallarit "Parimet themelore për hartimin e 'Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe" që u botua më 1968, ishte mbështetje e fortë teorike për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe.

Naim Frashëri farkues i terminologjisë

Naim Frashëri jetoi në një epokë të rëndësishme të popullit shqiptar. Gjatë kësaj kohe pati një zhvillim të madh të letërsisë, të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në përgjithësi. Ai jetoi e veproi në epokën më të ndritshme të popullit shqiptar, në kohën e Rilindjes Kombëtare, së bashku me shumë emra të tjerë, të cilët i vunë themelet e gjuhës e të letërsisë shqipe. Për Naimin e autorët e tjerë të Rilindjes, gjuha ishte shtylla kryesore e përparimit. Ata shpërfaqën pasuritë gjuhësore të shqipes, treguan se si ta përdorin këtë pasuri në krijimtarinë e tyre dhe e pasuruan atë në forma të ndryshme. Si njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe i pasurisë së saj dialektore, ai u përpoq që në veprimtarinë e tij të përdorte fjalë të thjeshta e të qarta, të përdorte sa më pak fjalë

[1] Fadil Raka, *Rreth disa problemeve të zhvillimit të terminologjisë së gjuhës letrare shqipe në kohën e Rilindjes Kombëtare*, në: Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 1984, f. 143-151.

[2] Po aty, f. 144.

të huaja dhe ta pasuronte shqipen edhe me neologjizma. Përveçse letrar, ai ishte edhe gjuhëtar i zoti, i cili punoi në përhapjen e dijeve shkencore. Ndonëse në krahasim me shkrimtarët të tjerë si Vreto, Vasa, Krishtofordhi, të cilët ishin bërë të njohur në mesin e shqiptarëve, Naimi do të hyjë më vonë në letërsi. Megjithëse do të hyjë vonë në letërsinë shqipe, e me këtë, edhe në përpjekjet për shkrimin e gjuhës së saj në pajtim me programin e Rilindjes Kombëtare, Naimi do ta ndihmojë shumë, madje më shumë se sa numri më i madh i shkrimtarëve të tjerë të kohës së tij, zhvillimin, pasurimin dhe përsosjen e gjuhës shqipe.[3]

Naimi zhvillimin e pasurimin e gjuhës shqipe e ndihmoi në fushat kryesore gjuhësore: në fushën e frazeologjisë, në fushën e sintaksës, e sidomos në fushën e leksikut. Roli që do të ushtrojë krijimtaria poetike, diturore dhe mësimore-shkollore e Naim Frashërit në zhvillimi, në pasurimin dhe në përsosjen e gjuhës shqipe në të vërtetë edhe fillon me përjashtimin e fjalëve të huaja dhe me krijimin, qoftë në vend të tyre, qoftë për të plotësuar kërkesat e tjera të reja shprehëse që i shartoheshin përpara, të një numri të dukshëm fjalësh të reja shqipe.[4] Së bashku me përhapjen e shkencave, u kujdes të përdoret një terminologji të qartë, të thjeshtë e të kuptueshme për masën. Këtë kujdes të tij e shohim jo vetëm në pasurimin e veprave të tij letrare, me elemente dialektore, duke marrë nga dialektet për ta pasuruar shqipen, si në veprat *"Istori e Skënderbeut", "Bagëti e bujqësia", "Lulet e verësë"*, por edhe në tekste mësimore "*E këndimit të çunavet këndonjëtoreja"*, I,II, "*Mësime*", "*Vjersha për mësonjëtorët e para*" etj., në të cilat shpërfaqi njohuritë e tij të thella për gjuhën shqipe.

Duke qenë edhe njohës i mirë i gjuhëve të huaja, kjo i ndihmoi që të hartonte vepra me fjalë-terma të pasur, duke shqipëruar, duke kalkuar, duke krijuar terma të rinj, e duke futur në përdorim edhe terma të krijuar nga romantikët e tjerë. Kjo terminologji kap fusha të shumta e të rëndësishme, sidomos në kohën kur hidheshin hapat e parë në shumë fusha të dijeve, si në astronomi, botanikë, anatomi, gjeografi, kimi, zoologji etj., si: *qart për horizont*, *degë për segment, lëndë për materie, thërmie për molekulë, dhetregonjë për gjeologji, ushtrësë për kazermë, të grime për sekonda, moll'e dheut për patate, erëpeshonjës për diametër, thartirë për oksigjen, ujëtore për hidrogjen, të holla për minuta, copë për kapitull, rrjeshtë për rimë, të patrupta për abstrakte, shoqëri për aleancë, mësimdhënës për profesor* etj. Megjithatë, nuk mund të thuhet se të gjitha fjalët, termat e nocionet e reja që përdori Naim Frashëri në veprimtarinë e tij janë të formuara në frymën e shqipes. Disa prej këtyre fjalëve, termave e nocioneve nuk do të mbesin në gjuhën shqipe dhe nuk do të përdoren prej shkrimtarëve të tjerë, si: *të holla, grime, fersah, pasës, rrotullohës, remb, ngaserë, nënë-mbret, lëkurçe, mbanjës, hietore, marrjeparje, gjysmë-kalë* etj., ndonëse numri më i madh i termave që i krijoi a i kalkoi janë të krijuar në pajtime natyrën fjalëformuese të shqipes.[5]

Po ta marrim në shqyrtim *Fjalor i Naim Frashërit*[6], fjalor i hartuar nga Dhimitër Shuteriqi, do të shohim këtë pasuri terminologjike të përdorur nga Naim Frashëri në veprat e tij. Fjalori shpërfaq një pasuri jo vetëm leksikore e frazeologjike por edhe terminologjike, duke përfshirë qindra terma, kryesisht me burim shqip, të marrë nga leksiku i shqipes e të krijuar me mjete e mënyra të ndryshme, të njohura në fushën e terminologjisë, si me parashtesa e prapashtesa, me kompozim, me togfjalëzim e me rikuptimëzim, pra duke u dhënë kuptime të reja fjalëve, si: *dritë, erë, truri, trupi, zorët, male që nxjerrin zjarr (vullkane), lëmsh i dheut (globi), kohët e motit (stinët), dhetregonjë (gjeologji)* etj. Ai në veprat e tij shqipëroi edhe një varg emrash njerëzish, vendesh, si: Argjendi (Argjentinë), Det'i Shqipërisë (Adriatik e Jon), Dheu i ri (ishull), Evgjitëri (Egjipti), Hindarak (Oqeani Indian), Japonak (Deti i Japonisë), Vëndet' e Bashkuarë (ShBA) etj.

[3] Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Prishtinë, 1990, f. 415.
[4] Po aty, f. 416.
[5] Po aty, f. 425.
[6] Dhimitër Shuteriqi, *Fjalor i Naim Frashërit*, Tiranë, 2017.

Terminologjia e përdorur nga Naim Frashëri përfshin fusha të ndryshme, si: gjeometri: *anë-kundrejt-i – paraleloid, anë-shumës-i – poliedër, brinjë-drejtë- figurë me brinjë të drejta, brinjë-ndryshe - figurë barabrinjëse, brinjë-përzjerë - figurë me brinjë të përziera, brinjë-shtrembërë -figurë me brinjë të shtrembëra, brinjë-shumë - figurë poligonale, çipëtore-je - lozansh, çakëtor-i – kubi, gjatërore-ja – katrori, kupëtimë-a – aksiomë, lartësimë-a – perpendikularja, purtekë-a – hipotenuzë, siprë-a – kulmi, vezake-ja – elipsi* etj.
Metale: *banad-i, barr-i - bariumi, beril-i, brom-i lloj metaloidi, dhidhym-i, dhimitër-i, dhor-i, engjërdhi-ja, erv-i, felor-i lloj metaloidi, indh-i, kadhëm-i, kovalt-i, lidh-i, llandan-i, mangon-i, pallad-i, qill-i, rrodh-i, ruthim, ruvidh-i* etj.
Zoologji: *bushtërë-a – qen, kapllan-i – tigri, petrit-i - shpend grabitqar, qifti-i - lloj shpendi grabitqar, ren-i - lloj dreri, tetëkëmbëse-ja – oktapodi, vezarake-ja – ovipare, xhibon-i - lloj majmuni* etj.
Gjeologji: *dhetregonjë-ja – gjeologjia, ardoaz-i - lloj shkëmbi, balaqils-i - lloj dheu, çukë-a – kodrinë, dollman-i - gur, monument megalitik i kohëve parahistorike, qils-i lloj dheu, shist-i - lloj toke, terë-a – toka*, *ardoaz-i - lloj shkëmbi* etj.
Gjeografi: *dheshkronjë-a, dheshkronjës-i, qerthull-i - lëmshi i dheut, globi, gjymësë lëmsh-i – hemisferë, mesës-i – paralele, notë-a – jugu, notë-lindje-ja – juglindje, notë-perëndim-i – jugperëndim, përnjëshmës-i – ekuatori, si-nisi-ja - siudhjesë* etj.
Me interes del terminologjia e emërtimeve të tjera, si: *anijëtor-i detar, detnotës, aniëri - detari-a, babëzi-ja - grykësi, tahmarqarllëk, berr-i - bagëti e imët, bërje-a – krijimi, brendësmë-i - njeri i brendshëm, britëm-i - muaji i tetorit, brymor-i - muaji nëntori, bujë-a – famë, byk-u - punëtori, Darovë-a – dhuratë, dejmarak-u – pijanec, dëllinjë-a - halë, dërrasë-a – tabelë, Ergjënt-i - punonjës-i, fe-zi-ja - fanatizmë, fëngji-ja - dritore, ftigë-a – lodhje, galë-a – stërkoq, kalënor-i – janar, kamës-i – pasaniku, kamje-a – pasuri, kthisës-i – muratori, kthisësi-ja – muratoria, lagë-a - deti, ujët, lagësirë-a – lagështi, ligë-a – zakon, ligj, mëmë-a – mitra, mësonjëtore-ja – shkolla, pendar-i -ai që nget qetë, qiellshkronjë-a – astronomia, shëronjës-i – mjeku, zerdeli-ja - lloj kajsie me bërthamë të hidhur* etj.
Fjalëve që u dha kuptime të reja, në këtë rast kuptime terminologjike në veprat e Naimit mund t'i përmendim: *anë-a* gjeogr, *borë-a* gjeogr, *bosht-i* gjeom, *brinjë-a* gjeom, *copë-a* gjeogr. *Çokëtonj* mat, *degë-a* gjeom. *Dërrasë-a* mat. *Funt-di* mat. *Grykë-a* gjeogr. *Hinkë-a* gjeom. *Hundë-a*, gjeogr. *Majë-a* gjeom. *Mëngë-a* gjeogr. *Notë-a* gjeogr. *Qendrë-a* fiz.gjeom. *rrip-i* gjeogr. *Rrotë-a* gjeom. *Vijë-a* gjeom., etj.
Përveç fjalë-termave njëfjalësh, Naimi përdori edhe togfjalësha terminologjikë, sidomos në tekstet "Mësime", "E këndimit të çunavet kundënjëtoreja", tekste të cilat shërbyen për mësime në shkolla. Në këto tekste paraqiten afro 470[7] terma njëfjalësh e togfjalësh të fushave të ndryshme shkencore. Nga termat togfjalësh mund t'i përmendim: *asht'i krahërorit, cip'e mushkërisë së bardhë, dej të hoj, dej të trashë* (nerva), *gjak i paqëruarë* (i papastër), *gjak i qëruarë* (i pasëtr), *mish i varfërë* (diafragmë), *mushkëri e bardhë, mushkëri e zezë, palcë e shtyllës së kurrizit, plaçkat e krahërorit, vegëlat e brendshme* (organet), *vegëlat e jashtëme koh'e gurit të ri, koh'e njeriut, koh'e paditurë, dërras e shumëzimit, metra të çokëtuara* (kub), *metra të katërtuara* (metra katërore), *numurat e dhetuara* (dhjetorë), *punë të numëratoresë, rrënjë e të çokëtuaravet, rrënjë e të katërtuaravet, bot'e diellit* (sistemi diellor), *koh'e kthyerjes mbi boshtit, pasës i diellit* (satelit), *madhëri e rrotullohësve, ndryshimet e hënës, shkëndijat e diellit* (rrezet), *degëza të holla, drurë që japin pemë, farë femëre, farë mashkulli, fletë me dhëmbë, fletë të drejta, lëng i dheut, rrënjë të drunjta, plaçkat e dorësë, erë e qëruarë* (ajëri pastër), *fuqi heqjes, shkëndijat e dritës, trupa të gaztë, trupa të tymtë, trupa të lënda, trupa të ngurëtë, valët e erësë, vrap i dritësë, anët e qarkut, bosht i dheut, brez i ngrohtë, brezë i nxehtë, madhëri e dheut, male që nxjerrin zjarr* (vullkane), *mërguarit e dheut nga dielli, palët e dheut*

[7] Hëna Pasho, *Leksiku terminologjik në veprën mësimore të Naim Frashëirt*, në Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe, Tiranë, 2017, f. 213.

(shtresat), *pull'e e veriut, e jugësë, rreth'e diellit, rreth i dheut, zemër e dheut, kënd i hapurë, kënd i mbyllurë, këndj'e truptë* (qoshe), k*on i prerë, pikë e pshtetjesë, gjuh e vdekurë, ndryshimet e gjuhësë* (dallimet), *rrën'e gjuhësë, istori e mesme, trupa të përzjerë, barëra të gjalla, gjërëra të gjalla me dy thonjë, kafshë këmbanike, kafshë të dheut, kafshë të ujit, kafshë që hiqen zvarrë* etj.

Përfundime

Siç mund të shihet nga shembujt, Naimi ka përdorur terma të krijuar në mënyra e mjete të ndryshme. Një nga mënyrat që e ka përdorur, e cila edhe sot e kësaj dite në gjuhën shqipe është prodhimtare është ndajshtimi. Prapashtesimi del më i përdoruri: *heqjes, këthyerja, zbritje, këndje, mbetje, ndarje, kuptime, qyrime, dëftime, bashkime, nguros, mermeros, shtrembërore, ujëtore, katërore, gjatëtore, i tymtë, i gaztë, i metaltë, i drunjtë, i lartë, fluturake, japonak, notorake, ecurake vezarake, ngrohtësi, pleqësi, i njëshëm, i ujshëm, dituri, mbretëri* etj. Edhe kompozimi ka zënë vend në mënyrat e krijimit të termave: *brinjë-përzjerë, bimë-rrëfenjë, dhe-tregonjë, njeri-tregonjë, kënd-mbyllur, kënd-hapur, qiell-shkronjë, dritë-shkronjë, dhe-masje* etj.

Gjatë veprimtarisë së tij, për Naimi, sikurse edhe për pjesën tjetër të romantikëve shqiptarë, gjuha ishte elementi kryesor i identifikimit kombëtar e i përparimit shoqëror, andaj ishte i bindur se shqipja mund të zhvillohej, të përsoset e të pasurohet me fjalë nga brumi i shqipes, duke i larguar fjalët e huaja nga gjuha shqipe. Naimi në veprën e tij krijoi fjalë të reja, mori fjalë të vjetra nga dialektet, përdorimi krahinorizma, zgjeroi, ndërroi e saktësoi kuptimin e fjalëve dhe shfrytëzoi frazeologjinë shqipe për ta pasuruar gjuhën. Termat që i krijoi vetë apo ata që i mori nga romantikët e tjerë ndikuan në krijimin e gjuhës diturore shqipe. Ato u përhapën dhe ndikuan në prirjen e krijimit të tjerave dhe të nocioneve në gjuhën shqipe dhe patën ndikim edhe në formimin e shkrimtarëve të tjerë, kaluan edhe në gjuhën e popullit, duke u bërë një pasuri e çmuar leksikore edhe për kohën e mëvonshme.

Referencat

[1]. Abdurrahim Maxhuni, *Terminologjia e kompjuteristikës në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2020.
[2]. Abdurrahim Maxhuni, *Leksiku terminologjik islam në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2023.
[3]. Agron Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001.
[4]. Agron Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
[5]. Dhimitër Shuteriqi, *Fjalor i Naim Frashërit*, Tiranë, 2017.
[6]. Hëna Pasho, *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2017.
[7]. Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Prishtinë, 1990.

Në vazhdim po e sjellim një korpus të leksikut dituror të përdorur nga Naim Frashëri, por edhe të fjalëve me karakteristika të veçanta, shumica nga të cilat nuk kanë arritur të jetojnë në gjuhën shqipe.

agëzotës-i dhe barut
agon-i ndeshje, takim
anë-kundrejt-i, gjeom. paraleloid.
anë-shumës-i, gjeom poliedër
anijëtor-i detar, detnotës, aniëri për detari-a
ardoaz-i, lloj shkëmbi
arjil-i, argjil
arrësim-i, edukata.
babëzi-ja grykësi, tahmarqarllëk

bakër-i, metal
balaqils-i, lloj dheu
balash-i, kalë me një pullë të bardhë në ballë.
balik-u, qen balash
baltak-u, batak, moçal
ballon-i, aerostat.
banad-i, lloj metali
barishte-ja, bar, bimë
barr-i bariumi, lloj metali
bashkimë-a, ati trupi që bëhet duke përzier dy lloj metale, i themi bashkimë
bathë-a bot.
beril-i, lloj metali, lloj esxmeraldi.
berr-i bagëti e imët.
besë-a, 1. feja, 2. fjala e dhënë.
bërës-i krijestari, perëndia
bërje-a, krijimi
brendësmë-i, njeri i brendshëm
brinjë-drejtë, gjeom. figurë me brinjë të drejta
brinjë-ndryshe, gjeom. figurë barabrinjëse
brinjë-përzjerë, gjeom. figurë me brinjë të përziera
brinjë-shtrembërë, gjeom. figurë me brinjë të shtrembër.
brinjë-shumë, gjeom figurë poligonale
britëm-i, muaji i tetorit
brom-i, lloj metaloidi
brymor-i, muaji nëntori
buçim-i, eksplozion bullkani.
bujazhgë-a, bujashkë
bujë-a, famë
bushtërë-a, zool qene
byk-u, punëtori
cipë-a, lëkura e njeriut, e drurit etj.
çap-i, lloj qeni, langua
çipëtore-je, gjeom. lozansh, shpiërtore
çakëtor-i, gjeom. kubi
çukë-a, kodrinë
darovë-a, dhuratë
dejmarak-u, pijanec
dell-i, anat. tendon dejt e dorës, nerv.
dëllinjë-a, - halë
dërrasë-a, mat. tabelë.
dëshmimë-a, provë, dëshmi
dëshmimë-dhënës-i, dëshmitar
dëshmimëtar-i, dëshmitar.
dimëror-i, muaji dhjetor.
dollman-i, gur, monument megalitik i kohëve parahistorike
druveëzë-a, tryezë.
dharovë-a, dhuratë.
dhemasje-a, gjeom.
dheshkronjë-a, gjeogra.
dheshkronjës-i, gjeogr.

dhetregonjë-ja, gjeologjia. (edhe dhe-tregonj)
dhidhym-i, lloj metali
dhimitër-i, lloj metali
dhimokrati-ja
dhor-i, lloj metali
engjërdhi-ja, metal, merkuri
erë-peshonjë-a parometër.
ergjënd'i, rremë-i kallaji
ergjënt-punonjës-i
erv-i, lloj metali
fajfalës-i, njeri që ia fal fajet tjetrit
falësoor-i, personi që falet, bën lutje zotit
felor-i, lloj metaloidi
fe-zi-ja, fanatizmë
fëngji-ja, dritore,
ftigë-a, lodhje
galë-a, stërkoq
gdhë-ri, nyje druri
glistërë-a, krimb dheu
govatë-a, korit
gjatarak-u, gjeom.
gjatërore-ja, gjeom. katrori
gjithurdhrësi-ja, republika. (një urdhronjë- monariki), veturdhronjë -autokraci)
gjymësë lëmsh-i gjeogr. hemisferë
hardhjeshkë-a, hardhucë
hasrit-i, zool. astrit, lloj gjarpëri
indh-i, lloj metali
iridh-i, metali, iridium
jeroglif-i, hieroglif
jetë-shkronjë-a, biografi
jugë-lindje-a, gjeogr.
jugë-perëndim-i
kadhëm-i, lloj metali
kafshëri-ja, të qenit kafshë.
kafshëshkronjë-a zool.
kalënor-i, janar
kallame-ja, vend i mbjellë me kallam
kamës-i, pasaniku
kamillë-a, deve
kamje-a, pasuri
kapllan-i, zool. tigri.
kaposh-i, këndes
kartë-shpënës-i, korrier
katër-këndje-a gjeom. katërkëndëshi barabrinjës
këllirë-a, gjë e ndryrë fortë, fundërri.
këmbës-i, këmbësori,
këndonjëtore-ja, libër këndimi
këndt-di, gjeom. kënt i drejtë i hapurë
kllapë-a, kurth, grackë
koritë-a, anije pa vela

kovalt-i, lloj metali
krye-gjatë-i, dolikoqefal
krye-gjerë-i, brakiqefal
kryes-i, kryetar
kthisës-i, muratori
kthisësi-ja, muratoria
kupëtimë-a, gjeom. aksiomë
kuvernar-i, qeveritar
kuvernari-ja, qark administrativ
lagë-a, deti, ujët.
lagësirë-a, lagështi
lagjin-i, ibrik balte.
laraskë-a, lloj zogu që i ngjet sorrës.
larash-i, lloj fajkoi
lartësi-a, lartësia shpirtërore
lartësimë-a, gjeom. perpendikularja
laturi-ja, ndyrësi, vepër e keqe.
lesë-a, portë e thurur me purteka, prej trine
lëfyt-i, anat. gurmazi.
lidh-i, lloj metali
ligë-a, zakon ligj.
ligjëri-ja, të ligjërruarit, oratoria.
llandan-i, m. lloj metali
llasë-a, f. kurajë.
magnis-zi, m. lloj metali, magneziumi
magje-ja, f.lloj anije
majarak-u, m. gjeom. kon.
mangon-i, lloj metali
mbimë-shkronjë-a
mbishkresë-a, f. titulli i një vepre të shkruar
mburonjës-i, m. rojtar.
mesës-i, m. gjeogr. paralele.
mëmë-a, f. anat. mitra.
mësonjëtore-ja, f. shkolla
mill-i, m. këllëfi i shpatës.
ngasërë-a, f. lagje
nijas-i, m. lloj faljeje bektashiane
niqel-i, m. lloj metali, nikel.
notë-a, f. gjeogr. jugu.
notë-lindje-ja, f. gjeogr. juglindje.
notë-perëndim-i, m. gjeogri jugperëndim.
numurë-i, m. numrë.
njeritregonjë-a, f. antropologji
një-ja, num. mat. njëshet.
pabesëri-ja, f. pabesëri.
pabërë-a, e. punë e ligë, shpifje.
pafillë-a, f. plloskë, enë teneqeje.
pafletë-a, e f. bot. bimë që nuk nxjerr fletë, as monokotiledone, as bikotiledone.
pallad-i, m. lloj metali.
pallangë-a, f. qendër e vogël banimi.

panginjësi-ja, f. të pangopurit.
paratoner-i, m. rrufeheqës.
pesë-këndje-a, f. gjeom. pentagon.
peshë-a, f. 1. arsye, gjykim, 2. mat. provë.
peshlli-ja, f. lloj xhamadani me mëngë.
petrit-i, m. zool. shpend grabitqar.
pendar-i, m. ai që nget qetë
përmiqyri-i, m. kujdestari
përnjëshmës-i, m. gjeograi ekuatori
përparë-i, m. mat. numri i sipërm i thyesës
pleqësi-ja udhëheqësia e shtetit
purtekë-a, f. gjeom. hipotenuzë.
qerthull-i, m. lëmshi i dheut, globi
qerre-ja, f. qerret e udhës së hekurtë, lokomotivat.
qiellshkronjë-a, f. astr.
qifti-i, m zool. lloj shpendi grabitqar.
qils-i, m. loj dheu.
qill-i, m. lloj metali.
qyrimë-a, f. gjeom. teoremë.
qytetri-ja, – qytetrimi.
raxha-ja, f. ndarje territoriale, shtet feudal indian.
re-ja, f. vërejtje, vëmendje.
ren-i, ., zool. një farë dreri.
rrodh-i, m. lloj metali
ruthim, m. lloj metali
ruvidh-i, m. lloj metali
rrëmp-bi, m. anat. arteriet, damarët.
rrëmullë-a, f. trazirë.
rrëshkitë-a, f. greminë. po edhe rrukullimë-a f. greminë.
rrotullohës-i, m. astr.
rrukullë-a, f. gjeom. cilindri.
saitë-a, f. gjeom. figurë.
serë-a, f. katrani
si-nisi-ja, f. gjeogr. siudhjesë
siprë-a, f. gjeom. kulmi.
stëhi-ja, f. fig. molekulë.
shëronjës-i, m. mjeku
shist-i, m. lloj toke
shpirt-rrëfenjë-a, f. psikologjia
shortë-a, f. votë.
shtatëliun-i, m. mat. septilion
shtrëmbërore-ja f. gjeom. trapez.
tejqyrë-a, f. mikroskop.
tejqyrës-i, m. teleskop.
teleshkronjë-a, f. telegrafi
terë-a, f. toka
tetëkëmbëse-ja f. zool. oktapodi.
trup-tregonjë-a, anatomia.
thyerë-a, mat. thyesa.
ujëtore-ja, f. kim. dhe idrozhen.

uj'i-varurë, m. ujëvarë.
uzurë-a, f. fajdeja.
vezake-ja, gjeom. elipsi.
vezarake-ja, f. zool. ovipare
xhibon-i, m. zool. lloj majmuni
zahar-i, m. zakonisht sheqer
zerdeli-ja, f. bot. Lloj kajsie me bërthamë të hidhur